ALB STAR SHPK

Forma juridike: SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Data e themelimit: 1995

Numri unik i indentifikimit(NIPT): J62903512W

Selia: PATOS , FIER

Objekti tregtar: Prodhim dhe tregtim te artikujve te konsumit te gjere

Pasqyrat Financiare Vjetore 2011

(Mbyllur më 31.12.2011)

Pasqyra financiare: Individuale(jokonsoliduara)

Periudha kontabel: Nga 01.01.2011 deri më 31.12.2011

Data e mbylljes:01 MARS 2012

Monedha: Leke

Shkalla e rrumbullakimit: ne leke

Tiranë, MARS 2012

Tabela e përmbajtjes

A. RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR 0

B. PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR 2

C. PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE GJITHËPËRFSHIRËSE 3

D. PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE 4

E. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALET E VETA 5

F. SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE 6-18

ALB-STAR SH.P.K

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010
(Të gjitha balancat janë në lekë)

		Shenimi nr.	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2011	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2010
A	**AKTIVET**			
I	**Aktive Afatshkurtera**			
	Aktive monetare	3	809,534,943	513,217,136
	Derivativë dhe aktive të mbajtura për tregtim			-
	Aktive të tjera financiare afatshkurtra	4	1,724,403,591	1,157,095,195
	Inventari & Prodhim ne proces	5	8,592,878	73,422,632
	Aktivet afatshkurtra të mbajtura për shitje		-	-
	Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra		53,991,136	32,782,658
	Totali i Aktiveve Afatshkurtera(I)		2,596,522,548	1,776,517,622
II	**Aktive Afatgjata**			
	Investimet financiare afatgjata		-	-
	Aktive afatgjata materiale	6	1,767,911,823	1,387,819,865
	Aktivet afatgjata jomateriale		-	-
	Kapital aksionar I papaguar		-	-
	Aktive të tjera afatgjata		-	-
	Totali i Aktiveve Afatgjata(II)		1,767,911,823	1,387,819,865
	TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		**4,364,434,371**	**3,164,337,487**
B	**DETYRIMET DHE KAPITALI**			
I	**Detyrime Afatshkurtera**			
	Huamarrjet	7	3,556,565	5,550,162
	Huatë dhe parapagimet	8	583,214,987	326,433,400
	Grantet dhe të ardhurat e shtyra		339,781,608	430,313,388
	Provizionet afatshkurtra			-
	Totali i Detyrimeve Afatshkurtera (I)		926,553,160	762,296,950
II	**Detyrime Afatgjata**			
	Hualë afatgjata	9	-	-
	Huamarrje të tjera afatgjata(Ortak)		-	-
	Provizionet afatgjata		-	-
	Grantet dhe të ardhurat e shtyra		-	-
	Totali i Detyrimeve Afatgjata (II)		-	-
	Totali I Detyrimeve (I+II)		926,553,160	762,296,950
III	**Kapitali**			
	Kapitali i rregjistruar (aksionar)	10	85,000,000	85,000,000
	Primi i aksionit			
	Njësitë ose aksionet e thesarit (negative)			-
	Rezerva statutore			-
	Rezerva ligjore	10	110,060,714	71,159,584
	Rezerva të tjera	10		-
	Fitimet(humbja) te pashpërndara	10	1,978,682,042	1,467,858,363
	Fitimi (humbja) e vitit financiar	11	1,264,138,455	778,022,590
	Totali i Kapitalit (III)		3,437,881,211	2,402,040,537
	TOTALI I DETYRIMEVE E KAPITALIT (I,II,III)		**4,364,434,371**	**3,164,337,487**

ALB-STAR SH.P.K

PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE GITHËPËRFSHIRËSE
Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010
(Të gjitha balancat janë në lekë)

		Shenimi nr.	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2011	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2010
1	Shitjet neto	11	6,414,410,171	3,659,588,132
2	Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit(Puna	.	6,582,250	50,900,649
3	Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe	.	-	-
4	Materialet e konsumuara,mallrat dhe sherbimet	11	2,939,532,723	1,559,786,264
5	Kosto e punës	11	404,806,926	313,055,751
	Pagat e personelit		364,016,054	280,697,554
	Shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetsore		40,790,872	32,358,196
6	Amortizimet dhe zhvlerësimet		218,088,230	162,286,798
7	Shpenzime të tjera		1,428,339,352	806,278,051
8	**Totali i shpenzimeve (shuma 4 - 7)**		**4,990,767,231**	**2,841,406,864**
9	**Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1+2+/-3-8)**		**1,430,225,190**	**869,081,917**
10	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e kontrolluara		-	-
11	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet		-	-
12	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	11	**(25,047,402)**	**(4,297,508)**
	12.1 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tiera financiare afatgjata		-	-
	12.2 Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat 767, 667		(10,966,920)	(10,025,661)
	12.3 Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi 769, 669		(14,080,482)	5,728,153
	12.4 Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668		-	-
13	**Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare (**		(25,047,402)	(4,297,508)
14	**Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)**		**1,405,177,788**	**864,784,409**
15	**Shpenzimet e tatimit mbi fitimin 69**	12	**141,039,333**	**86,761,819**
16	**Fitmi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)**	11	**1,264,138,455**	**778,022,590**
17	**Elementët e pasqyrave të konsoliduara**		-	-

ALB-STAR SH.P.K

PASQYRA E RRJEDHJES SE PARASE (cash flow)
Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010
(Të gjitha balancat janë në lekë)

	Shenimi nr.	Ushtrimi I mbyllur 31.12.2011	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2010
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitimi para tatimit		1,405,177,788	864,784,409
Rregullime për:		(282,382,012)	194,783,138
Amortizimin		218,088,230	162,286,798
Humbje nga këmbimet valutore		-	-
Të ardhura nga investimet		-	-
Shpenzime për interesa		-	-
Rritje/rënie në tepricën e kërkesave të arkëtueshme nga aktivit		(588,516,874)	(125,512,111)
Rritje/rënie në tepricën inventarit		64,829,754	(69,506,274)
Rritje/rënie në tepricën e detyrimeve, për t'u paguar nga aktiviteti		164,256,211	314,276,544
Mjete monetare të përfituara nga aktivitetet		-	-
Interesi I paguar		-	-
Tatim mbi fitimin i paguar		(141,039,333)	(86,761,819)
Mjete monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		1,122,795,776	1,059,567,547
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese			
Blerja e shoqërisë së kontrolluar X minus paratë e arkëtuara		-	-
Blerja e aktiveve afatgjata materiale		(598,180,188)	(567,955,229)
Të ardhura nga shitja e pajisjeve			
Interesi i arkëtuar		-	-
Dividendët e arkëtuar		-	-
Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet investuese		(598,180,188)	(567,955,229)
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare			
Hyrje nga emetimi I kapitalit aksioner		-	-
Hyrje nga huamarrje afatgjata			-
Pagesat e detyrimeve të qirasë financiare		-	-
Dividendët e paguar		(228,297,781)	(149,202,183)
Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet financiare		(228,297,781)	(149,202,183)
KONTROLLI		296,317,807	342,410,135
Rritja/rënia neto e mjeteve monetare		**296,317,807**	**342,410,135**
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël		**513,218,136**	**170,807,001**
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël		**809,535,943**	**513,217,136**

ALB-STAR SH.P.K

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL
Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010
(Të gjitha balancat janë në lekë)

	Kapitali i rregjistruar (aksionar)	Primi i aksionit	Rezerva ligjore statusore	Fitimi pashpërndarë	Totali
Pozicioni më 01 Janar 2010	85,000,000	(50,901,700)	33,603,469	1,705,518,361	1,773,220,130
					-
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	778,022,590	778,022,590
Dividentët e paguar	-	(149,202,183)	-	-	(149,202,183)
Emetim i kapitalit aksionar	-	-	-	-	-
Rritje e rezervës së kapitalit	-	-	37,556,115	(37,556,115)	
Aksione te thesarit te riblera	-	-	-	-	-
Hua pronari afat shkuter					-
Pozicioni më 31 Dhjetor 2010	85,000,000	(200,103,883)	33,603,469	1,705,518,361	2,402,040,537
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	1,264,138,455	1,264,138,455
Dividentët e paguar	-	(228,297,781)	-	-	(228,297,781)
Emetim i kapitalit aksionar	-	-	-	-	-
Rritje e rezervës së kapitalit	-	-	38,901,130	(38,901,130)	
Aksione te thesarit te riblera	-	-	-	-	-
Hua pronari afat shkuter					-
Pozicioni më 31 Dhjetor 2011	85,000,000	(428,401,664)	72,504,599	2,930,755,686	3,437,881,211

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i "**ALB-STAR " SH.P.K** dhe jane firmosur nga:

Sadik ISMAILAJ

NDËRTIM * PRC JEKTIM * IMPORT * EKSPORT
AlbStar shpk
FIER - SHQIPËRI

ADMINISTRATORI

Elsa SEMA

HARTUESE

Drejtore e Finance -Kontabilitetit

Fier , me _____2012

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE
Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010
(Të gjitha balancat janë në lekë).

1. TE PERGJITHSHME

HISTORIA DHE KRIJIMI

" ALB-STAR " sh.p.k , eshte themeluar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me vendim te gjykates se rrethit gjyqesor Tirane nr.8918 date 15 Shkurt 1995 me ortak te vetem z.Sadik ISMAHILAJ .
Me vendim te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane nr. 8918/1 date 27 Qershor 2002 eshte bere shitja e e 50% te kuotave te kapitalit tek z. Idajet ISMAILAJ .
Ne baze te Certifikates Deklaruese te TVSH-se me nr.330036592 dhe nr.Fiskal , 600203820 , date 28.01.2010 ,shoqeria " ALB-STAR " sh.p.k , ka hapur nje dege ne Kosove , Prishtine me seli : Kroj I Bardhe , Lokali 47 , Prishtine , Kosove .
Kapitali rregjistruar aktualisht eshte 85.000.000 leke dhe zotrohet teresisht nga ortaket e shoqerise :

- Z.Sadik ISMAILAJ 50% te kapitalit themeltar
- Z.Idajet ISMAILAJ 50% te kapitalit themeltar

Keto pasqyra financiare jane paraqitur ne leke Shqiptare (Leke) meqense kjo eshte monedha ne te cilen jane kryer pjesa me e madhe e transaksioneve te Shoqerise .

AKTIVITET KRYESOR

Veprimtaria kryesore tregtare e shoqerise per ushtrimin 2011 jane sherbimet ne fushen e ndertimit dhe te infrastruktures.

DREJTUESIT

BORDI DREJTUES

EMRI	FUNKSIONI	VENDI
Sadik ISMAILAJ	Administrator	Fier
Idajet ISMAILAJ	Administrator	Fier
Elsa SEMA	Drejtore e Finance -Kontabilitetit	Fier

2.BAZAT E PERGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE DHE POLITIKAT KONTABILE

2.1 Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

a- Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare te konsoliduara janë pergatitur në përputhje me ligjin shqiptar 'Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Nderkombëtare të Raportimit Financiar (S.N.R.F) të vendosura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (B.S.N.K).

b- Baza e matjes

Pasqyrat financiare te konsoliduara janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE
Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010
(Të gjitha balancat janë në lekë).

2.1 **Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**

c- Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare te konsoliduara paraqiten në monedhën kombëtare të Republikës së Shqipërisë Lekë (LEK), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

Diferencat e konvertimit perfshijne te gjitha diferencat nga kurset e kembimit si pasoje e konvertimit te pasqyrave financiare te veprimtarise se filialit te huaj ne monedhen funksionale dhe raportuese te Shoqërisë. Monedha funksionale e deges se Kososvës eshte Euro.

d- Bazat e konsolidimit

Pasqyrat financiare perfshijne pasqyrat financiare te Shoqërisë dhe deges se saj per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor.

Filialet

Filialet jane të gjitha entitetet mbi të cilat Shoqëria ka te drejte te drejtoje politikat financiare dhe operative ne menyre qe te perfitoje te mira prej ushtrimit te aktivitetit te tij. Gjate vleresimit te kontrollit, te drejtat e votes qe ushtrohen aktualisht, jane marre ne konsiderate. Pasqyrat financiare te filialeve jane te perfshira ne pasqyrat financiare qe nga data e fillimit te ushtrimit te kontrollit deri ne daten qe ky kontroll merr fund.

Tepricat qe rrjedhin nga marredheniet brenda grupit, dhe te ardhurat e shpenzimet e parealizuara qe burojne nga transaksione brenda grupit, jane eliminuar ne momentin qe jane pergatitur pasqyrat financiare.Te ardhurat e parealizuara jane eliminuar ne pergatitjen e pasqyrave financiare.Shpenzimet e parealizuara jane eliminuar ne te njejten menyre si te ardhurat e parealizuara, por vetem ne ate mase kur nuk ka tregues per zhvleresim.

(e) Përdorimi i çmuarjeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF-të kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund te ndryshojnë nga këto çmuarje.
Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë egzistencën e saj operacionale edhe për një të ardhme të parashikuar

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE
Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010
(Të gjitha balancat janë në lekë).

2.2 Politikat kontabël kryesore

Politikat kontabël e paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme gjatë të gjitha periudhave të paraqitura në pasqyrat financiare të konsoliduara.

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën përkatëse funksionale duke
përdorur kurset e këmbimit në datat e transaksioneve. Aktivet dhe detyrimet monetare të shprehur në monedha të huaja në datën e raportimit rivlerësohen në monedhën funksionale duke përdorur kurset e këmbimit në atë datë. Fitimet dhe humbjet nga këmbimi që rezultojnë nga shlyerja e transaksioneve në monedhë të huaj dhe nga rivlerësimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare të shprehur në monedhë të huaj njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqeria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2011 jane :

EURO : LEK 138.93
CHF: LEK 114.46
USD : LEK 107.54

(b) Të ardhurat

Të ardhurat njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara.Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri te mjaftushme ne marrjen e perfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përllogaritet me besueshmëri.Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej te treteve dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura.

(c) Kostot e huamarrjes

Kostot e huamarrjes perfshijne interesin e paradhenieve bankare dhe huave afatshkurtera dhe afatgjata . Kostot e huamarrjes njihen si shpenzim ne periudhen qe ato jane shkaktuar pavarsisht se si huate jane aplikuar .

(ç) Tatimin mbi fitimin

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin perfaqson shumen e tatimit per tu paguar per vitin ushtrimor.Tatim fitimi i pagueshem per vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem per vitin . Fitimi i tatueshem ndryshon nga fitimi neto qe raportohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve sepse ai perjashton zera te te ardhurave dhe shpenzimeve qe jane te tatueshme apo te zbritshem ne vite te tjere dhe gjithashtu perjashton zera qe nuk jane kurre te tatueshem apo te zbritshem . Detyrimi i shoqerise per tatim fitimin e vitit llogaritet duke perdorur normat e tatimit te percaktuara nga legjislacioni shqiptar dhe ate te Kosoves per kontabilitetin ne Shqiperi dhe Kosove . Norma aktuale e tatimit mbi fitimin eshte 10 % (2010-10%)
Per shkak se nuk ka diferenca të përkohshne në njohjen e aktiveve dhe detytimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, atehere nuk rezulton aktiveve tatimore të shtyra apo detyrime tatimore të shtyra.

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE
Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010
(Të gjitha balancat janë në lekë).

2.2 Politikat kontabël kryesore (vazhdim)

(d) Aktivet dhe detyrimet financiare

Njohja

Mjetet dhe detyrimet financiare njihen ne bilancin kontabel te shoqerise kur Shoqeria behet pale ne kushtet kontraktore per instrumentin .

Matja me kosto të amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi njihet në momentin fillestar duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt çvlerësimi.

(i) Mjetet Monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë mjetet monetare në arkë, mjetet monetare në bankë.

(ii) Kërkesat për t'u arkëtuar

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parà njihen fillimisht me vlerën e tyre të drejtë dhe në bilanc maten me kosto të amortizuar.

Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për çvlerësim), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

(iii) Detyrimet financiare

Detyrimet financiare jane klasifikuar sipas llojit te marrveshjes kontraktuale.
Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parà, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Risku I kreditimit

Risku I kreditimit te Shoqerise kryesisht I vishet kerkesave per arketim dhe aktiveve te tjera te saj . Gjendjet e paraqitura ne bilancin kontabel jane zvogeluar nga provigjonet (shumat e parashikuara) per kerkesat e dyshimta per arketim , te vleresuara nga drejtimi I shoqerise mbi bazen e experiences se meparshme dhe vleresimit te mjedisit ekonomik actual .
Shoqeria nuk ka perqendrim te rendesishem te riskut te kreditimit , me nje zbulim te shperndare ne nje numur te madh te tretesh dhe klientesh .

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE
Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010
(Të gjitha balancat janë në lekë).

2.2 .Politikat kontabël kryesore(vazhdim)

(dh) Aktivet afatgjata materiale (AAM-të)

Aktivet afatgjata materiale(AAM-të) maten me koston e blerjes minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga çvlerësimi,përveç tokës, e cila paraqitet me kosto minus humbje nga çvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzime të cilat i atribuohen direkt blerjes së aktivit. Kostot e aktiveve të ndërtuara vetë-përfshijnë kostot e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër që lidhet me vënien e aktivit në punë për qëllimin e përcaktuar dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes dhe ristrukturimin në vendin në të cilin ato ndodhen. Programi kompjuterik i blerë, i cili është një pjesë e rëndësishme e pajisjes funksionale kontabilizohet si pjesë e pajisjes. Kur pjesët e një zëri të ndërtesës dhe pajisjeve kanë jetë përdorimi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndarë (komponentët kryesorë) të tokës, ndërtesës dhe pajisjeve.

Kostoja e pjesëve të zëvendësuara të tokës, ndërtesës dhe pajisjeve njihet me vlerën e mbartur nëse është e mundshme që përfitime të ardhshme ekonomike do të vijnë për Shoqërinë dhe kostot e tij mund të njihen në mënyrë të besueshme. Kostot e mirëmbajtjes së përditshme njihen në fitim ose humbje në momentin kur lindin.

Amortizimi eshte llogaritur mbi bazen e metodes lineare per ndertesat dhe mbi bazen e vleren se mbetur per pjesen tjeter te aktiveve afatgjata materiale , duke ngarkuar pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve si me poshte .
Normat e aplikuara per vitet 2011 dhe 2010 jane :

Ndertesa	5%
Instalime teknike dhe makineri	20%
Mjete transporti	20%
Paisje zyre	20%
Paisje informatike	25%

(e) Inventaret

Inventaret jane paraqitur me vleren me te ulet midis kostos dhe vleres neto te realizueshme .
Kosto e inventarëve dhe perbehet nga materiale direkte dhe , ne rastet kur eshte e aplikueshme , kostot e punes direkte dhe ato kosto te pergjithshme qe jane ndeshur per te sjelle inventare ne vendin dhe kushte aktuale magazinimi . Kosto eshte llogaritur duke perdorur metoden e mesatares se ponderuar .

Vlera neto e realizueshme perfaqson cmimin e vleresuar te shitjes minus kostot e vleresuara te perfundimit dhe kostot e marketingut , shitjes dhe shperndarjes .
Gjendjet e inventarit ne pasqyrat financiaret paraqiten me kostot e blerjeve te fundit te ushtrimitt qe nga drejtimi eshte çmuar si vlera neto te realizueshme.

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE
Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010
(Të gjitha balancat janë në lekë).

3. Aktive monetare (likujditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mjetet monetare ne banke dhe arke, ne leke dhe valute, ne datat 31 Dhjetor 2011 dhe 31 Dhjetor 2010 jane si me poshte:

Emertimi I Llogarise	Monedha	Gjendja ne 31.12.2011		Gjendja ne 31.12.2010	
		Ne leke	Ne valute	Ne leke	Ne valute
Llogari bankare	LEK	61,632,026	-	172,957,468	-
Llogari bankare	LEK	742,090,451	5,341,470.17 €	332,692,568	2,397,438.70 €
Llogari bankare	LEK	447,053	4157.09 $	437,318	4204.98 $
Llogari bankare	LEK	1,007	8.8 chf	8,891	80.11 Chf
Arka ne leke	LEK	5,364,406	37667.42E&760$	7,120,891	49952.14€ &760
Xhirime te brendshme	LEK	0			
Shuma		**809,534,943**	x	**513,217,136**	x

Gjendjet e llogarive te likujditeteve te paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejta me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave.Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, jane konvertuar ne leke duke përdorur kursin e këmbimit të fundit te ushtrimit te bankes respektive.Llogaria bankare ne euro perbehet nga 5324717.91euro alb-star shpk,dhe **16752.26** euro **alb-star shpk Kosova** .Arka ne euro perbehet nga: 5.2 euro alb-star shpk,dhe **37662.22** euro **alb-star shpk Kosova**

4. Aktive të tjera financiare afatshkurtra

Kerkesat e arketueshme dhe aktive te tjera financiare, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2011 deklarohen si vijon:

	Ushtrimi I mbyllur 31 Dhjetor 2011	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2010
Aktive të tjera financiare afatshkurtra		
(i) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme(411)	1,724,403,591	1,157,095,195
(ii) Llogari / Kërkesa të tjera (avanset e dhena kosove)		32,782,658
(ii) Llogari / Kërkesa të tjera llog409,445,449	53,991,136	
(iv) Investime të tjera financiare	0	0
Shuma	1,778,394,727	1,189,877,853

Ne "Llogari / Kërkesa të arkëtueshme " ne shumen 1724403591 leke , jane pasqyruar vlerat e akumuluara te kerkesa te arketueshme ndaj klienteve per shitjen e mallrave dhe sherbimeve.Ne Llogarine /Kerkesa te tjera te arketushme ne shumen 53991136 leke,tvsh 38675538 m dhjetor,dogana 146164 leke,13845938 jane parapagimet per blerje dhe qera te deklarura si dhe parapagim per kontraktorin Kosove (1500euro*138.93)dhe tvsh m dhjetor kosove(8026.34 euro*138.93). Drejtimi mendon se te gjitha kerkesat do te arketohen ne nje periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie ne vlere.

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE
Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010
(Të gjitha balancat janë në lekë).

5. Inventari

Gjendjet e inventarit ne fillim dhe fund te ushtrimit paraqiten:

	Ushtrimi I mbyllur 31 Dhjetor 2011	Ushtrimi I mbyllur 31 Dhjetor 2010
Inventari		
(i) Lëndët e para	8,592,878	4,884,987
(Ii) Prodhim në proces(Puna ne proces)Kosove		68,537,645
(iii) Produkte të gatshme	-	-
(iv) Mallra për rishitje	-	-
(v) Parapagesat për furnizime(INVENTAR)	-	
Shuma	8,592,878	73,422,632

Vlerat e inventarit te paraqitura me siper perputhen me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike e kryer ne fund te ushtrimit 2011. Veprimet ekonomike qe lidhen me hyrjet e daljet jane tranzituar ne llogarite e rezultatit me menyren e inventarit te ndermjetem. Si politike kontabel ne percaktimin e kostos se inventarit eshte perdorur metoda mesatare e ponderuar.Vlera e inventarëve të njohura si shpenzim gjatë periudhës kontabël 2011 eshte 2939532723 leke.
Shuma e inventarit te paraqitur ne " Lëndët e para" perfaqson stokun e materialeve qe perdoren ne procesin e sherbimeve per te trete te alb-star shpk ne vlere 8592878 leke.
Drejtimi mendon se vlera e paraqitur eshte vlera me e ulet mes kostos se marrjes dhe vleres neto te realizueshme dhe nuk eshte nevoja per zhvleresime te tij.

6. Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale ne pasqyrat financiare paraqitet si vijon:
Ne 000/Leke

	Gjendjet dhe levizjet	Toka	Ndertesa	Makineri dhe paisje	Aktivet te tjera afatgjata materiale	Totali
A	Kosto e AAM-ve 01.01.2011	176,970	463,512	891,632	353,092	1,885,206
	Shtesat	87,190	27,288	371,468	119,701	605,647
	Pakesimet	-	-	(8,417)	(500)	(8,917)
	Kosto e AAM-ve 31.12.2011	264,160	490,800	1,254,683	472,293	2,481,936
B	Amortizimi i AAM-ve 01.01.2011	-	43,001	203,070	251,315	497,386
	Amortizimi ushtrimit		15,400	156,369	46,319	218,088
	Amortizimi per daljet e AAM-ve	-	-	(1,216)	(233)	(1,449)
	Amortizimi i AAM-ve 31.12.2011	-	58,401	358,223	297,401	714,025
						-
C	Zhvleresimi AAM-ve 01.01.2011	-	-	-	-	-
	Shtesat	-	-	-	-	-
	Pakesimet	-	-	-	-	-
	Zhvleresimi AAM-ve 31.12.2011	-	-	-	-	-
D	Vlera neto e AAM-ve 01.01.201	176,970	420,511	688,562	101,777	1,387,820
						-
	Vlera neto e AAM-ve 31.12.2011	264,160	432,399	896,460	174,892	1,767,911

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE
Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010
(Të gjitha balancat janë në lekë).

6. Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te) (vazhdim)

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit dhjetor 2011.Si politike kontabel per kontabilizimin dhe spjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e kostos(SNK-5).Vleresimi fillestar ne momentin e marrjes ne inventar eshte bere me koston e marrjes dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.Shtesa prej 605647mije eshte e alb-star shpk dhe .Amortizimi 218088 mije leke perbehet nga 217165mije lek alb-star shpk,dhe 923 mije leke(6.64 mije euro) eshte e alb-star shpk Kosova.
Drejtimi mendon se pergjithesisht per kete ushtrim kontabel, nuk ka shenja te renjes ne vlere te AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvleresime.
Metodat dhe normat e amortizimit te AAM-ve te perdorura jane njejta me ato qe perdoren per qellime fiskale.(shih shenimin nr.3) Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijte e njohur per efekte fiskale.

7. Detyrime afatshkurtera-Huamarrjet

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2011 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2010
Huamarrjet		
(i) Huatë dhe obligacionet afatshkurtra	3,556,565	5,550,162
(ii) Kthimet / ripagesat e huave afatgjata	0	0
(iii) Bono të konvertueshme	0	0
Shuma	3,556,565	5,550,162

" Huate afatshkurtera " perfaqeson kredine ne forme overdrafti te marre nga Union Bank ne 70.000 Euro per blerje mjete transporti per nevoja te shoqerise per alb-star shpk .

8. Detyrime afatshkurtera-Huate dhe parapagimet

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2011 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2010
Huate dhe parapagimet		
(i) Te pagueshme ndaj Furnitoreve	501,185,534	282,442,225
(ii)Te pagueshme ndaj Punonjesve	30,529,825	29,168,207
(iii)Detyrime tatimore	51,499,628	14,822,968
(iv)Huara te tjera		
Parapagimet e arketuara	339,781,608	430,313,388
Shuma	922,996,595	756,746,788

"Të pagueshme ndaj furnitorëve" pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e mallrave e sherbimeve pa u likujduar ne fund te ushtrimit.Kjo vlere perbehet nga : 472585228 leke te alb-star shpk,dhe 28600306.45 leke(205727.06 euro) te alb-star shpk Kosova.Shoqeria ka pergatitur inventaret

8 Detyrime afatshkurtera-Huate dhe parapagimet (vazhdim)

kontabel dhe shuma e llogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e llogarive analitike te mbajtura per cdo furnitor.

Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane te vleresuara realisht.
"Të pagueshme ndaj punonjësve" perbehet nga detyrimi i papaguar ndaj personelit ne 31.12.2011.
"Detyrimet tatimore+sig.shoqerore" perfaqesojne detyrimin per tatimin mbi fitimin ne shumen **40240315** leke,nga te cilat TF tirane 38881616 leke,dhe 1358699 leke kosove, tatimin mbi te ardhurat personale (TAP) ne **shumen 5714053**leke,(5682099lekeTR,31954leke kosove) dhe per sigurimet shoqerore e shendetesore te muajit dhjetor 2011 **ne shumen 5545260** leke(5509145lekTR, dhe 36115 lek kosova).
Ne"Parapagimet e arketuara" shumen 339781608 leke nga te cilat alb-star shpk 296680332 leke ,dhe 43101276 leke (310237.36 euro)alb-star shpk Kosova, pasqyrohen **paradheniet e faturuara** dhe te arketuara per periudhat e ardheshme , dhe per te cilat shoqeria i detyrohet shtetit per tatim fitimin per v 2012.

9. Detyrime Afatgjata-Huate afatgjata

Huate afatgjate ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2011 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2010
DETYRIME AFATGJATA		
I-Huatë afatgjata		
